

## GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e 47, deri më 24.11.2024)


### Të dhëna javore

Gjatë javës së dyzetë e shtatë të vitit 2024 (nga 18-24.11.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 63 raste ( $I=3,4/100.000$  banorë) të të prekurve nga grip/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 1 më pak se javën e kaluar (64). Krahasuar me javën e dyzetë e shtatë të vitit të kaluar (51), numri është rritur për 23,5%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (73) është regjistruar një rënie prej 13,4%.

Gjatë javës së 47 të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 14 materiale për analiza laboratorike për gripin, nga të cilat 6 nga mbikëqyrja SARI dhe 8 nga mbikëqyrja rutinore, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19 dhe të gjitha kanë rezultuar negative për prani të virusit të gripit.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit ( $I=26,1/100.000$ ) është nën pragun sezonal, pra ende nuk është arritur pragu i aktivitetit sezonal për hyrje në sezonin e gripit (Grafiku 1).

**Grafiku 1.** Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025



Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në Kumanovë – 13, Tetovë – 11, Strumicë – 10, Gostivar-9, Sveti Nikole – 5, nga 3 në Kavadar, Prilep dhe Shkup – 5, nga 2 në Negotinë dhe Radovish dhe nga 1 në Koçan dhe Berovë.

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 32 persona, tek grupmosha 5-14 – 22, tek grupmosha mbi 65 vjet – 8 dhe tek fëmijët nga 0-4 -1 rast.

### **Të dhëna kumulative**

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 389 raste ( $I=21,2/100.000$ ).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar ( $n=402$ ), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rënie prej 3,2%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit ( $n=403$ ) është regjistruar një rënie prej 3,6%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 14 QSHP/NJR. Numri më i madh ( $n=122$ ) është regjistruar në Kumanovë, ndërsa incidencë më e lartë kumulative ( $115,8/100.000$ ) është regjistruar në territorin e Gostivarit.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) - 235 raste (60,4%), ndërsa incidencë më e lartë ( $39,1/100.000$ ) tek fëmijët e moshës 5-14 vjet ( $n=84$ ).

### **MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE**

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e 47, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 134 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Deri më tani janë regjistruar 2 raste me SARS-CoV-2. Nuk janë regjistruar raste pozitive me grip dhe RSV.

### **VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 68.448 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.684 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 70.132 persona me vakcina falas dhe komerciale.

### **RAJONI EVROPIAN - ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary)**

\*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e 46 të sezonit të ri 2024/2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit është në nivel messezonal, që është karakteristike për këtë periudhë të vitit.

Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 9 nga 34 vende të rajonit evropian të OBSH-së.

Numri i rasteve me SARS-COV-2 vazhdon të bjerë, por ka dallime mes vendeve. Grupmoshat më të mëdha vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të rasteve. Aktiviteti i gripit dhe RSV mbetet në nivel të ulët, por me një rritje të shkallëzuar në 4 javët e fundit. Aktiviteti i virusit të gripit vazhdon të jetë i ulët.

Në nivel rajonal, pranimet në spital dhe në repartet e kujdesit intensiv si pasojë e gripit dhe RSV janë në nivele stabile. Pranimet si pasojë e SARS-COV-2 po bien.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse  
Instituti i Shëndetit Publik**